



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1254/2 Prot.

Tiranë, më 11. 09. 2025

V E N D I M

Nr. 212, Datë 11. 09. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 185, datë 27.08.2025, të paraqitur nga z. A. M., kundër shtetasve: V. R., dhe A. Zh., në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore” dhe “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës subjekti ankues, në mes të tjerash, parashtrohet se: *Jam A. M. Kërcënimi i jetës, diskriminimi, shantazhi, denigrimi nga dy persona të dënuar, V. R. dhe A. Zh., kanë filluar ndaj meje që jam me statusin i padënuar, i paraburgosur, ku diskriminimi ka ndodhur që nga data 1 gusht 2025 deri në këto momente, pa pushim. Ky trajtim nga këta të dënuar fillon nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 22 të mbrëmjes, pa pushim, duke më sharë e ofenduar me fjalë fyese, të pahijshme, diskriminuese ndaj meje si A., familjes, mamasë dhe shtatë fëmijëve të mi. Janë fjalë diskriminuese aq të rënda, sa asnjë burrë me dy rr nuk i mban dot; nuk i mban as toka dhe as qielli.*

Unë, A. M., vuaj nga shumë sëmundje: diabet, veshka, mëlçi e dhjamosur dhe e zmadhur, nervi... nuk funksionojnë sipas Institutit të Mjekësisë Ligjore me nr. vendimi 1483, datë 19.05.2019, dëmtim i përhershëm dhe i parikuperueshëm. Pagjumësi e thellë, stres, ankth, aritmi, tmerr, depresion, halucinacione ditë dhe natë. Gjendja ime si A. M., psikologjike, mendore, emocionale, shpirtërore, shëndetësore, është tejet e rënduar. Singerisht, nuk po e përballoj dot. Jam drejt vetëvrasjes dhe po i lë shtatë fëmijët në rrugë. Jam shumë i mërzhitur. Duhet të merren masa urgjente, të menjëhershme. Ju lutem, shpëtoni jetë.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Personat V. R. dhe A. Zh. të dërgohen në një IEVP tjetër, pasi këta dy persona të dënuar nuk kërcënojnë vetëm jetën time në mënyrë serioze, dhe diskriminojnë rëndë ndaj meje, por cenojnë edhe sigurinë e gjithë burgut. Ose, nëse nuk është e mundur largimi i tyre, të më transferojnë mua në IEVP Durrës, pasi e kam më afër familjen, e cila më vjen një herë në javë për vizitë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Bazuar në nenin 3/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Bazuar në nenin 33/3, të LMD-së përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”*.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44/2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme: b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”*.

Neni 7 i LMD-së¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjerash personash, përbën diskriminim”.

Për të vlerësuar legjitimitetin e palës kundër të cilit drejtohet ankesa, Komisioneri do i referohet parashikimeve të bëra në nenet 24, 25 dhe 26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Kështu, në këtë kod përcaktohet përmbajtja e personit juridik: “24. *Personat juridikë janë publikë dhe privatë. 25. **Personat juridikë publikë** janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen. 26. **Persona juridikë privatë** janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji*”.

Referuar parashikimeve të mësipërme, vlerësohet se “sektori publik” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të administratës, ndërmarrjeve publike dhe organizmave publikë të sigurimeve shoqërore, ndërsa “sektori privat” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të personave juridikë privatë, sipas përcaktimeve të nenit 26, të Kodit Civil.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përmbushje të qëllimit të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, shqyrton ankesat që drejtohen kundër autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë.

Bazuar në informacionin e paraqitur dhe në rrethanat e përshkruara, rezulton se V. R. dhe A. Zh., janë dy individë të dënuar, të cilët ndodhen aktualisht në të njëjtin institucion të vuajtjes së dënimit me A. M., që është i paraburgosur dhe i padënuar. Këta persona janë individë privatë, që nuk ushtrojnë funksione publike dhe nuk ofrojnë shërbime publike apo private, dhe si të tillë, nuk kanë asnjë rol në jetën publike apo në sektorët shtetërorë dhe privatë.

Për sa më sipër, bazuar në dispozitat e cituara më lart dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, rezulton se, V. R., dhe A. Zh., nuk legjitimohen si subjekte kundër të cilëve mund të paraqitet ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi².

Bazuar në Ligjin Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” të ndryshuar, dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve (VKM nr. 209/2022), një person i paraburgosur ka të drejtë të paraqesë ankesa dhe kërkesa lidhur me trajtimin e tij,

¹ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

² Për analogji citojmë: Vendimi nr. 73, datë 19.03.2018, Vendimi nr. 120, datë 30.06.2021. Vendimi nr. 237, datë 19.03.2021, Vendimi nr. 120, datë 10.12.2021

kushtet e paraburgimit, apo çdo shkelje të pretenduar të të drejtave të tij. Kjo e drejtë garantohet nga nenet 58 dhe 59 të ligjit, ku parashikohet se ankesa mund të drejtohet te personeli i institucionit, drejtori i institucionit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministri i Drejtësisë, Avokati i Popullit, organizata vendase ose ndërkombëtare, dhe organet e drejtësisë. Ankesa mund të paraqitet me shkrim ose verbalisht (e cila dokumentohet me procesverbal). Pas regjistrimit, drejtori i institucionit ngarkon personelin përkatës për shqyrtimin e saj dhe kthimin e përgjigjes brenda një afati jo më të gjatë se 14 ditë. Në rast mosmarrje përgjigjeje ose pakënaqësie me vendimin, i paraburgosuri ka të drejtë të ankohet në mënyrë administrative pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve brenda 30 ditëve, dhe më pas, nëse është e nevojshme, pranë gjykatës kompetente, sipas nenit 80 të këtij ligji.

Përsa i përket kërkesës për transferim, procedura dhe kompetencat përkatëse janë të përcaktuara në nenin 78 të Ligjit Nr. 81/2020 dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Një paraburgosur mund të paraqesë kërkesë për transferim për arsye të sigurimit të jetës dhe shëndetit, mbipopullimit në institucion, nevoja për hetim apo gjykim, arsye shëndetësore ose familjare. Kërkesa drejtohet fillimisht drejtorit të institucionit ose Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila ka kompetencën për të marrë vendimin për transferim. Transferimi kryhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, dhe në rast refuzimi të kërkesës, i paraburgosuri njoftohet me shkrim dhe ka të drejtë ankimi pranë Ministrit të Drejtësisë brenda 15 ditëve nga marrja dijeni. Po ashtu, organi procedues (prokuroria dhe/ose gjykata) njoftohet për çdo rast transferimi të një paraburgosuri. Procedura parashikon që i paraburgosuri të transferohet së bashku me sendet personale dhe dokumentacionin përkatës, dhe qëndrimi i tij në institucionin pritës ka për detyrë të respektojë të njëjtat të drejta dhe standarde si më parë.

Sa më sipër, bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ... b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”*

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 44, pika 2, nenin 65, germa b) të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b dhe 10 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues z. A. M., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA